

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit S.A. nga fsh. S., komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.2517/2016 datë 13.06.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1nr.193/2018 datë 23.04.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur më 01.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S.A. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.2517/2016 datë 13.06.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.193/2018 datë 23.04.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.2517/2016 datë 13.06.2017 i dënuari S.A. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 26.10.2016 e deri me datën 12.04.2017 dhe dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqindën) € të cilën shumë është i obliguar ta paguaja në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € me një ditë burgim. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës sado që të jenë ato, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.193/2018 të datës 23.04.2018, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S.A. av. B.Gj. nga Prizreni për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim ose aktgjykimet të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga përgjegjësia penale.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.150/2018 të datës 31.08.2018, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë bërë shkeljen e ligjit penal neni 385 KPPK ,sepse vepra për të cilën i dënuari është shpallur fajtor nuk është vepër penale dhe ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës , pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërrënie me vet veten e as me arsyetimin e tij, po ashtu i njëjti në përshkrimin faktik të veprës penale përmban të gjitha elementet objektive dhe subjektive të cilat përbëjnë figurën e veprës penale. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë përshkruar në mënyrë të qartë veprimet inkriminuese të të dënuarit që përbëjnë veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë, pra mënyra se si i dënuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë si në dispozitiv po ashtu edhe në arsyetimin e aktgjykimit ka përshkruar veprimet e të dënuarit e lidhur me këto veprime ka dhënë arsye bindëse duke i mbështetur edhe në prova konkrete, për çka kjo gjykatë vlerëson se pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pabazuar.

Pjesa tjetër e kërkesës, i referohet, gjendjes faktike mirëpo këto pretendime nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 432 par.2 të KPRK.

Megjithatë, vlen të theksohet se fajësia e të dënuarit që ndërlidhet me pretendimin për shkeljen e ligjit penal pra, përshkrimi faktik dhe cilësimi juridik i veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtorë, nuk mund të vihet në dyshim. Kjo nga fakti se mbështetur në provat e administruara dhe drejt të vlerësuara përfundimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë të drejta dhe të ligjshme meqë në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i dënuari në periudhën kohore dhe mënyrën siç është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë ,me datën 03.07.2016 gjatë orëve të natës në fsh. N. KK P., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, ia merr pasurinë e të dëmtuarit R.K., në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, dhe me mjet të përshtatshëm hap derën e bagazhit të automjetit “..-..”, me targa të regj...-...-.. e cila ishte e parkuar në afërsi të ambulancës dhe nga bagazhi i automjetit merr mjete pune dhe largohet nga vendi i ngjarjes. Nga ana tjetër me provat e administruara, deklaratën e të dëmtuarit R.K., vërtetohet se natën kritike iu është thyer me forcë automjeti i tipit “..-..”, dhe atë dera e bagazhit dhe nga automjeti iu janë vjedhur veglat e punës. Në anën tjetër nga dëshmitë e dëshmitarëve I.Sh. dhe S.R. të cilët në detaje i kanë përshkruar faktet, rezulton se ditën kritike kanë qenë në shoqëri me të dënuarin S.A., ku gjatë qëndrimit të tyre në afërsi të ambulancës së fshatit N., i dënuari atyre u kishte propozuar që të shkojnë për të vjedhur në automjetin e parkuar të markës “V..-P..” pronë e të dëmtuarit R.K. Më tej, nga deklaratat e tyre është vërtetuar se dëshmitarët e lartpërmendur nuk kanë pranuar që të kryejnë një veprë të tillë, dhe ata kanë qëndruar në kodër aty afër ndërsa i dënuari i vetëm ka shkuar në drejtim të automjetit ku me përdorimin e forcës e ka hapur bagazhin dhe nga aty ka marrur mjete të punës (vegla) dhe me vrap është larguar nga vendi i ngjarjes. Po ashtu, se i dënuari e ka kryer veprën penale, kjo është vërtetuar edhe me vet deklaratën e të dënuarit të dhënë në polici ku e ka pranuar kryerjen e veprës penale, ku gjatë dhënies së deklaratës ka qenë prezent edhe mbrojtësi i tij dhe përkthyesi. Pra, përmes administrimit të këtyre provave, në tërësi është vërtetuar kryesi, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK dhe për të gjitha këto fakte është dhënë arsyetim ligjor. Andaj, me faktin se i dënuari është shpallur fajtor, drejt është aplikuar ligji penal, për çka pretendimi nuk u aprovua.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 par.1 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 01.10. 2018, Pml.nr.231/2018

Procesmbajtëse,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa